



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 232/3 prot.

Tiranë më 20.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 14, datë 20.02.2019

PËR KONTROLLUESIN "AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Agjencia e Prokurimit Publik*".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.42 datë 08.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Agjencia e Prokurimit Publik*", me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Veprimtaria e saj bazohet në ligjin nr.9643/2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, ligjin nr.125/2013 "*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*" dhe ligjin nr. 9874/2008 "*Për ankandin publik*" i ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.app.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në "*Politikat e Privatësisë*", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*" dhe Vendimit nr. 6/2013 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*.

2. Kontrolluesi nuk ka *"Njoftuar"* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar: *"...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por kërkuan kohë për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi *"Agjencia e Prokurimit Publik"*, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet *"Politikës së Privatësisë"* në portalin zyrtar <http://www.app.gov.al>.
2. Kontrolluesi *"Agjencia e Prokurimit Publik"*, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit *"Njoftimin"* në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
3. Kontrolluesi *"Agjencia e Prokurimit Publik"*, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbyshja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përmbyshje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të

ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 20.02.2019.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHqipërisë", "KOMISIONI I LUFTËS SHTABORË NË NJERËTË", "DHE", "INFORMIMIT", "DHE", "KOMUNIKIMIT", "PUBLIK", "DHE", "TIRANË".